

POP 5

Lajmet më të lexuara të 5 minutave të fundit

1



Ndërron jetë 50-vjeçari që tërhoqi qenin zvarrë me makinë rreth një javë më parë

2



Shërrí masiv në Durrës për 'pse më sheh' nisi në berberhane, përfundoi në përplasje mes fiseve! Ky është Klodian Daci që vrau Baboçin e i plagosi të birin

3




Vendimi skandaloz i drejtësisë për Fjolla Morinën! Me dy armë, gjykata e lë në 'arrest shtëpie'! Këngëtarja mashtrroi, nuk është shtatzënë! Mjeku 'arratiset'/ Video

4



Mbollën kanabis në shtëpi me vlerë 500 mijë paund, në pranga 3 shqiptarë në Angli

5




Vrau 33-vjeçarin me thikë për zënien e rrugës, Arbër Kotaj nuk

Aktualitet

Fier/ 31-vjeçari futet në oborrin e shtëpisë së vjehrrit dhe kërcënon të vrasë veten me automatik! Negocion policia

31-vjeçari Elton Meta kërcënon të vrasë veten me armë automatike, në oborrin e shtëpisë së vjehrrit të tij. Ngjarja e rëndë po ndodh në fshatin Zhupan të Fierit. Gjatë një momenti kur kishin kaluar më shumë se 2 orë, 31-vjeçari ka qëlluar me armë zjarri në ajër.



SH

Redaksia

20 Shtator, 00:22 | Përditësimi i fundit: 20 Shtator, 13:13

Share 26 Tweet

WhatsApp

Një 31-vjeçar, Elton Meta, kërcënon të vrasë veten me armë automatike, në oborrin e shtëpisë së vjehrrit të tij. Ngjarja e rëndë po ndodh në fshatin Zhupan të Fierit.

Burime nga policia thonë se situata e rëndë nisi pas një konflikti për motive ende të pazbardhura, ndërsa i riu është prej vitesh i martuar me vajzën e shtëpisë ku po kërcënon me vetëvrasje, me të cilën ka një fëmijë.

SH

LEXO EDHE:

Fier/31-vjeçari kërcënoi se do vriste veten, prindërit për Report Tv: Eltoni donte të shihte vajzën, që ia mori nusja! Ajo fliste prej kohësh me dikë në telefon (VIDEO)

Policia thotë zyrtarisht përmes një njoftimi paraprak se familjarët që ndodheshin në banesë janë evakuuar nga forcat policore të Fierit dhe 31-vjeçari ndodhet i vetëm në oborr teksa mban armën në duar drejtuar nga vetja me kërcënimin për t'i dhënë fund jetës.

Policia thotë se nuk ka persona të lënduar dhe se drejt kësaj banese kanë mbërritur dhe forcat RENEA të specializuar për të negociuar që situata të mos shkojë drejt vetëvrasjes. 31-vjeçari kërcënon të vrasë veten me armë automatike prej orës 22:30, njofton policia e Fierit.

Gjatë një momenti kur kishin kaluar më shumë se 2 orë, 31-vjeçari ka qëlluar me armë zjarri në ajër, një veprim ky që dyshohet të jetë marrë për të refuzuar negociatat nga policia dhe për të kërkuar largimin e efektivëve.

Banesa është një vilë 3 katëshe me dy hyrje, ndërsa i riu ndodhet në oborrin e hyrjes kryesore.

Është ende e paqartë se përse 31-vjeçari ka shkuar në shtëpinë e vjehrrit, pasi duhet theksuar se ai dhe bashkëshortja nuk banojnë aty.

Burimet thonë se i riu punon vazhdimisht në Greqi, si emigrant, dhe se konflikti që e ka cuar në gjendje të rënduar psikologjike, mund të ketë lindur pas ndonjë kërkesë të mundshme për divorc nga ana e bashkëshortesh.

Për të ndihmuar grupin negociator është edhe motra e 31-vjeçarit.

Lajmi kryesor:
Fier/Arrestohet pas 5 orë negociatash 31-vjeçari Elton Meta, kërcënoi se do vetëvritej me kallashnikov në shtëpinë e vjehrrit! Sekuestrohet arma, 2 gëzhoja dhe 25 fishekë (VIDEO)

B.K./b.ha./Shqiptarja.com
TAG: fier policia e fierit vjehri tentative vetevrasje

SH

Sondazhi i ditës:

Me 14 muaj punë, gjyqtarja që liroi Fjolla Morinën merr zakonet e 'drejtësisë së vjetër'! A është kjo drejtësia e re që prisnit?

PO JO NUK E DI

Lajme të tjera

Aktualitet



Krujë/Taksia me 6 sirianë del nga rruga përfundon në kanal, plagoset rëndë një prej emigrantëve, dërgohet te Trauma në Tiranë

22 Shtator, 22:22

Aktualitet



Vrau 33-vjeçarin me thikë për zënien e rrugës, Arbër Kotaj nuk pranohet në burgun e Durrësit

22 Shtator, 21:38

Aktualitet



Mbollën kanabis në shtëpi me vlerë 500 mijë paund, në pranga 3 shqiptarë në Angli

22 Shtator, 21:16

Aktualitet



Dy mjete përplasen në Laç, në aksident përfshihet edhe një biçikletë! Një i vdekur (Pamjet)

22 Shtator, 20:50

Aktualitet



Ngjarjet kriminale në Elbasan, ndryshime në sektorin e hetimit të vrasjeve

Elton Qyno

22 Shtator, 20:37

Aktualitet



Xhaçka i jep gradën gjeneral brigade Arben Kingjit: Meritokracia dhe profesionalizmi, guri i themelit për FA-në

22 Shtator, 20:06